



Prishtinë, 28 qershor 2013
Kodi i ZRRE-së: V_543_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenet 14 dhe 17 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Lëshimin e Njoftimit mbi Autorizimin Preliminar, me Nr. V_365_2011 të datës 28 prill 2011, i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së,
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 57.8 MW që përbëhet prej pesë (5) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: "Kuqishta" me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, "Drelaj I" me kapacitet të instaluar prej 4.3 MW, "Drelaj II" me kapacitet të instaluar prej 5.4 MW, "Shtupeq" me kapacitet të instaluar prej 11.6 MW dhe "Rugova" me kapacitet të instaluar prej 31.8 MW, të gjitha në komunën e Pejës, të datë 24.04.2013 të ndërmarrjes "Kelkos-Energy" sh.p.k., me adresë rruga "Zagrebit" nr.19/22, Prishtina, Republika e Kosovës,
- Shkresës për tërheqje të kërkesës për shtyrje të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V_365_2011, të bërë me datë 27 qershor 2013,

në seancën e mbajtur me datë 28 qershor 2013 nxori këtë:

V E N D I M

- I. PËRFUNDON** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_365_2011 i datës 28 prill 2011.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 09.08.2010 nga ndërmarrja "Kelkos-Energy" sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 57.8 MW që përbëhet prej pesë (5) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: "Kuqishta" me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, "Drelaj I" me kapacitet të instaluar prej 4.3 MW, "Drelaj II" me kapacitet të instaluar prej 5.4 MW, "Shtupeq" me kapacitet të instaluar prej 11.6 MW dhe "Rugova" me kapacitet të instaluar prej 31.8 MW, të gjitha në komunën e Pejës.
- o Me datë 28 prill 2011 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga ndërmarrja "Kelkos-Energy" sh.p.k., ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_365_2011.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.



- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim përcaktohet se ndërmarrjes “Kelkos-Energy” sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
 - Me datë 24.04.2013 ZRRE nga ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_365_2011 të datës 28 prill 2011, ndërsa me shkresën e ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k të datës 27 qershor 2013, është tërheq kërkesa për vazhdim të afatit e cekur më lartë.
 - Ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., në shkresës për tërheqje të kërkesës për shtyrje të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V_365_2011, të bërë me datë 27 qershor 2013, ka sqaruar se shkak për këtë tërheqje janë ndryshimet e bëra në projektin fillestarë, e që kanë shty këtë ndërmarrje të përgatisë aplikacionin e ri dhe të aplikojë në ZRRE.
 - ZRRE pas analizimit të shkresave të Ndërmarrjes “Kelkos-Energy” sh.p.k dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_365_2011 i datës 28 prill 2011, **shfuqizohet.**
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar